



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:228957

Datë: 28.03.2024

Numri i dokumentit: 05519275

**C.nr.169/2017**

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm -Divizioni Civil,** me gjyqtarin Blerim Istrefi, dhe me praktikantin Bardh Avdiu, në çështjen juridike - kontestimore të paditësve: F.K dhe F.B, që të dy nga M, të cilët i përfaqëson av. B.S, me seli në P, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Siguria” me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit me shkrim e përfaqëson av. B. D, nga P, dhe Kompania e Sigurimeve “Sigal” me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson S. D, Baza e kontestit: Kompensim dëmi material dhe jo material, pas mbajtjes se seancës se shqyrtimit kryesor në prezencën e te autorizuarve te palëve ndërgjyqëse, në seancën e shqyrtimit kryesor me date 25.03.2024, me datë 28.03.2024, nxjerr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I.APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR** kërkesë padia e paditësve: F.K dhe F.B, ashtu që **DETYROHET** e paditura Kompania e Sigurimeve “SIGURIA” në Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material, me ndarje të përgjegjësisë prej 80% të shkaktuar në aksidentin e datës 29.12.2016, ti paguaj shumat e përgjithshme të detyrimit prej 2,127.60€ dhe atë si në vijim:

Për paditësen F.K,

**Dëmi jo material:**

- për dhimbjet e përjetuara fizike ..... 700 €
- për shkak të frikës së përjetuar ..... 700€

**Dëmi material**

- në emër të ndihmës se personit te tretë 5 ditë në shumën prej 50€
- në emër të ushqimit të përforcuar 18 ditë në shumën prej 140€
- në emër rehabilitimit klimiatik 10 ditë x 15 € dita shumën prej 150€
- në emër të shpenzimeve të mjekimit shumën prej 35.20€.

Për paditësin F.B,

Në emër të 80% të dëmit material të shkaktuar në automjetin e tipit Volkswagen 225 me targa - 02-733-AC, ashtu që **DETYROHET** e paditura Kompania e Sigurimeve “SIGURIA” që paditësit Fadil Bajraktarit t’ia paguajë shumën prej 402.40€.

**II. APROVOHET SI E BAZUAR** kërkesa e paditësve lidhur me kamatën, ashtu që **DETYROHET** e paditura Kompania e Sigurimeve” SIGURIA” me seli në Prishtinë, që shumat e gjykuara, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi për dëmin material dhe jo material në total prej 2,127.60 €, ti paguaj me kamat ligjore prej 8%, dhe atë për dëmin material në shumë të përgjithshme prej 777.60€, kamata do të rrjedhë nga data 31.03.2017, kurse për dëmin jo material në shumë të përgjithshme prej 1,400.00€, kamata do të rrjedh nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit datë 28.03.2024, e deri në pagesën definitive të detyrimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

**III. REFUZOHET PJESËRISHT SI E PABAZUAR** kërkesëpadisë së paditësve përtej pjesës së aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, me të cilën kanë kërkuar që të obligohet të paditurat KS” SIGAL” dhe KS “SIGURIA” që paditësve F.K dhe F.B, të ja kompensoj shumat dhe atë për dhimbje fizike, shumën prej 3,300.00€, për frikën e pësuar, shumën prej 3,300.00 €, për ndihmë personit të huaj shumën prej 100.00€, në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 60.00 euro, për rehabilitim fizik 150.00 €, apo shumën e përgjithshme për të gjitha kategoritë e dëmit prej 7,810.00€, pasi që shumat e kërkuara nuk janë në harmoni me dëmin, përgjegjësin e pjesëmarrësve në komunikacion dhe praktikën gjyqësore.

**IV. APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR** kërkesa e paditësve lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, ashtu që **DETYROHET** e paditura Kompania e Sigurimeve “SIGURIA” me seli në Prishtinë, që paditësve në emër të 80 % të përgjegjësisë tua paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 1,477.60 €, €, të gjitha në afat prej 15 ditësh , nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

**V. REFUZOHET PJESËRISHT SI E PABAZUAR** përtej pjesës së aprovuar si në pikën V të dispozitivit të këtij aktgjykimi kërkesa e paditësve lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, në shumën prej 1,123.40€.

### A r s y e t i m

Paditësit, përmes të autorizuarit të tyre me padinë e ushtruar në seancën kryesore dhe në fjalën ka deklaruar se mbetem në tërësi pranë padisë si dhe parashtrësës mbi precizimin e padisë, duke theksuar se në këtë procedure me provat e mjaftueshme është vërtetuar baza juridike përkatësisht është vërtetuar se te paditurat kane në mënyrë solidare përgjegjësi për kompensimin e dëmit të cilën e kanë pësuar paditësit në aksidentin e dt. 29.12.2016.

Konsideron se në provat e tjera është vërtetuar po ashtu edhe lartësi e kërkesë padisë përkatësisht është vërtetuar se paditësja F.K ka pësuar lëndime të shumëfishta ne këtë aksident dhe po ashtu

është vërtetuar lartësia e dëmit të shkaktuar në automjetin e paditësit F.B. Shumat e kërkuar për kompensim janë shuma reale dhe sado pake paraqesin një kompensim për demin që e kanë pësuar paditësit në këtë aksident. Më tutje shtoi se sa i përket kundërshtimit të paditurës se dyte për arritjen e parashkrimit të kërkesës ndaj të njëjtës mbetemi pranë pretendimeve të paraqitura në seancën e dt. 01.03.2024 duke konsideruar se në bazë të dispozitave ligjore arritja e parashkrimit nuk qëndron, andaj gjykatës i ka propozuar që kërkesë padinë e precizuar ta aprovoje në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë 208.00 € në emër të padisë, (për dy paditësit dhe të paditurën e dytë), për pesë seanca për përfaqësim nga avokati shumë prej 1,352.00€ (270.40 x 5- për dy paditës dhe të paditurën e dytë), parashtrësia për precizim padie në shumë prej 208.00€, parashtrësia për zgjerim të padisë në shumë prej 208.00€, taksën për padi në shumë prej 25.00€, për ekspertizë mjekësore shumë prej 300.00€, për ekspertizë të Komunikacionit shumë prej 150.00€, për ekspertizë të Makinerisë shumë prej 150, apo në total shuma prej 2,601.00€.

E paditura e parë në përgjigje në padi gjatë shqyrtimit kryesore dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk është kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë për 80% të përgjegjësisë dhe i ka ofruar ofertë paditësve për të gjitha format e dëmit për 80% të përgjegjësisë në shumë prej 1,400.00 €, po ashtu ka shtuar që mbetet në tersi gjatë gjithë deklaramëve përgjatë shqyrtimit gjyqësorë, duke i propozuar gjykatës që në rastin e vendosjes lidhur me kërkesë padinë e palëve paditëse ta aprovoje në nivel të ofertave të dhëna ndërsa përtej këtyre shumave ta refuzojë si të pa bazuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar dhe i ka propozuar gjykatës të vendoset mbi bazën e suksesit në procedurë dhe të njëjtat nuk i kërkojmë.

E paditura e dyte gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë deklaramëve të dhëna në këtë procedurë duke e kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësve në raport me të njëjtën për shkak të parashkrimit pasi që aksidenti ka ndodhur me dt. 29.12.2016 ndërsa zgjerimi i padisë në aspektin subjektiv është kërkuar dhe lejuar me dt. 01.02.2024 që i bie pas tetë viteve nga ndodhja e aksidentit, e konform nenit 376 kërkesëpadia e paditësve është parashkruar, po ashtu është parashkruar edhe me vepër penale, andaj i ka propozuar gjykatë që kërkesëpadia e paditësve të refuzohet në tersi si e pa bazuar në raport me të paditurën e dytë.

Gjykata në këtë çështje juridike - kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, sipas propozimit ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar provat: Raporti me nr. të rastit 2016 BR-968 i dt. 29.12.2016, Raporti i aksidentit me nr. të rastit 2016 BR-968 i dt. 29.12.2016, Procesverbali mbi dëmtimin e automjetit 05.01.2017, Polica e sigurimit e lëshuar në emër të paditësit F.B se bashku me certifikatën e regjistrimit të automjet, Raporti i lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm” Dr. S.H” në M- Emergjencia e dt. 30.12.2016, Raporti i lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm” Dr. S.H” në M- Emergjencia e dt. 29.12.2016, Raporti për dhënien e terapisë për paditësen F.K e dt. 03.01.2017, Raportet nga konsulta të lëshuar në emër të paditëses F.K të

datave: 04.01.2017, 05.01.2017, Fletëza kompjuterike shëndetësore e dt. 05.01.2017, Dëftesat te lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm” Dr. S.H” ne M, në emër të paditëses te dt. 05.01.2017 dhe 05.05.2017, Dy kupon fiskal te dt. 30.12.2016, Ekspertizat nga lëmia psikiatrisë dhe ortopedisë, makinerisë dhe komunikacionit si dhe Procesverbalin e dt. 13.03.2024.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç, dhe të gjitha së bashku e në lidhmëni njëra me tjetrën, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8, të Ligjit për Procedurë Kontestimore, gjykata erdhi në përfundim se në këtë çështje juridike – kontestimore duhet vendosur si në pikën I, II, III,IV, dhe V të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nga referati i padisë dhe raporti i aksidentit nr. 2016 -BR-968 dt.29.12.2016 është konstatuar fakti se ka ndodhur aksident i trafikut rr: Fadil Deliqi, K-M, ku janë përfshi automjeti i markës “VW Golf” me targa te regjistrimit 02-454-CL që e ka drejtuar R.I sipas raportit të policisë njësia A, automjeti të tipit “ VW 255” me targë 02- 733-AC, të cilin e drejtonte F.K, sipas raportit të policisë njësia B, dhe automjetit të tipit Mercedes 124-T, me targë 02-412-AG, sipas raportit të policisë njësia nën C, ku si ngasës i automjetit nën “B” lëndime trupore ka pësuar tani paditësja F.K, ashtu që deri të aksidenti ka ardhur kur automjeti (A) ishte duke lëvizur në rrugën e quajtur rr: “Fadil Deliqi” nga qendra e qytetit në drejtim të lagjes Bair dhe me të arritur me saktë në afërsi tek DPT “ E” nga pakujdesia duke mos përshtatur shpejtësinë e lëvizjes dhe kushteve të rrugës pasi që rruga ishte e rrëshqitshme, drejtuesi humb kontrollin ndaj automjetit dhe del në shiritin e kundërt të lëvizjes dhe ku me pjesën përparme anësore të anës se djathtë e godet automjetin B, në pjesën e prapme anësore të anës së majte, i cili në atë moment ishte i ndalur para tij në drejtim të lëvizjes dhe nuk e kishte vendosur trekëndëshin e sigurisë në rruge si pasoj e goditjes automjeti B me pjesën e përparme të anës së djathtë e godet automjetin C, në pjesën e prapme të anës së majte, i cili në atë moment ishte i parkuar përpara hyrjes se shtëpisë se B.B dhe si pasoj e kësaj përveç dëmeve materiale ne automjet, lëndime marrin drejtuesi i automjetit A dhe bashkudhëtarja ne automjetin B.

Është kundërshtuara rrethanat se si ka ndodhur aksidenti po ashtu si dhe lartësia e demit, andaj kanë kërkuara dhe ekspertizën mjekësore nga lëmia e Ortopedisë, Psikiatrisë si dhe ekspertiza nga lëmia e Makinerisë dhe Komunikacionit.

Përgjatë procedurës gjyqësore rezultoi të mos jetë kontestues fakti se është shkaktuar aksidenti i komunikacionit me datë 26.12.2016, në të cilin paditësja F.K kishte pësuar lëndime trupore, kurse paditësit F.B ishte shkaktuar dëm material në automjet.

Nuk ishte kontestuese kontributi 80% me 20%, mirëpo si çështje kryesore dhe kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse ishte, lartësia e kompensimit që duhet t’i njihet paditësve, si dhe periudha e kohës se ndodhjes se aksidentit, për të cilat përfaqësuesit e palëve ndërgjyqëse kanë paraqitur argumente të ndryshme mes tyre rreth parashkrimit.

Paditësja me kërkesën ju kishte drejtuar te paditurës se parë për kompensimin e demit material dhe jo material, të cilën kërkesë e paditura e ka pranuar dhe ka kthyer përgjigje.

Me këtë paditësit ka shterur mundësin e arritjes se marrëveshjes për aksidentin në fjalë duke ju drejtuar gjykatës me padi.

Pasi që nuk ishte kontestues kontributi i palëve ndërgjyqëse, gjykata për të vërtetuar lartësinë e kërkesë padisë, sipas propozimit të autorizuarit të paditësve, ka nxjerr provën me anë të ekspertëve mjekësore nga lëmia e Ortopedisë Dr. V.B si dhe në lëmin e Psikiatrisë Dr.Sh.H, të cilët kanë dhënë mendimin e tyre profesional në seancën e dt. 13.03.2024, ku të njëjtit kanë bërë ekzaminimin e palës së dëmtuar dhe kanë dhënë konstatimin në bazë të shqyrtimit dhe analizimit të dokumenteve mjekësore në shkresat e lëndës, të cilët janë deklaruar për natyrën, shkallën dhe pasojat e lëndimeve që ka pësuar paditëses F.K si pasojë e këtij aksidenti.

Ekspertja, Dr. V.B, Ortopede –traumatolog, në bazë të ekzaminimit të palës së dëmtuar dhe të dokumentacionit mjekësor i cili gjendet në shkresat e lëndës, ka konstatuar se paditësja F. K ka pësuar lëndime trupore-ndrydhje të qafës e cila me vone është shoqëruar me marremdje dhe kokëdhimbje, këto lëndime bëjnë pjesë në lëndime të lehta trupore. Paditësja ka pësuar dhimbje fizike të intesitetit të rënd me kohëzgjatje prej 24 orëve, dhe kryesisht me dhimbje regjionin e qafës.

Dhimbje fizike të intesitetit të mesëm që kanë zgjatur edhe për 18 dite tjera, dhe atë dhimbje në qafe si pasojë spasm të muskujve para vertebral të qafës për çka edhe ka mbajtur qaforen e bute.

Dhimbje fizike të intesitetit të ulët që kanë zgjatur edhe intensivisht edhe për një muaj, ndërsa sipas të dhënave anemestike ende ka dhimbje të kohëpaskohshme në qafë sidomos në lëvizje të shpeshtave të qafës dhe pozitive të detyruar.

Paditësja nuk ka zvogëlim të aktivitetit jetësorë, nuk ka shëmtim trupor.

Është nevojitur terapi fizikale me kohëzgjatje prej 10 ditësh për përforcimin e muskujve të regjionit të qafës pas ndrydhjes. Shpenzimet në shkresat e lëndës i përgjigjen mjekimit si pasojë e aksidentit në fjalë.

Lidhur me nevojën për ndihmën e personit të tretë, eksperti ortoped ka paraqitur se për paditësin ka qenë e nevojshme ndihma e personit të tretë në kohëzgjatje prej pesë ditësh dhe atë ndihma për aktivitetet e përgjithshme jetësore rreth ushqimit, veshmbathja, higjiena dhe ndihma gjatë trajtimit mjekësorë, për çka edhe gjykata e ka aprovuar shumën prej 50€.

Përveç kësaj, sipas ekspertit ortoped, edhe ushqimi i përforcuar i pasur me proteina, minerale dhe vitamina, ka qenë i nevojshëm 18 ditë për paditësin, në atë mënyrë që gjykata e ka aprovuar shumën prej 140 €.

Për rehabilitimin fizioterapeutik, eksperti ka gjetur se për paditëses F.K ka qenë i nevojshëm 10 ditë brenda vitit të parë pas aksidentit, për çka edhe gjykata ka aprovuar shumën 150 euro, po ashtu në bazë të kuponëve fiskal të dt. 30.12.2016 dhe dëftesë pagesave të dt. 05.01.2017 dhe 05.02.2017, të prezantuar si prova nga paditësja F.K, e të cilat shpenzime në ekspertja gjyqësore-ortopede ka konstatuar se të njëjtat shpenzime përkojnë me natyrën e lëndimeve të paditëses, andaj gjykata ja njohu shumën prej 35.20€.

Në emër të kompensimit për frikën e pësuar dhe në emër të dhimbjeve fizike në aksidentin e komunikacionit, gjykata i ka caktuar shpërblimin paditëses, duke e konsideruar si shpërblim të drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit, bazuar në ekspertizën e psikiatrisë të datës 13.03.2024. Gjykata për paditësen F.K për frik dhe për dhimbje fizike ka caktuar shumën nga 700 €, apo ne total 1,400.00€(700x2+1400€), sepse paditësja sipas mendimit të ekspertit psikiatër, në mendimin e tij lidhur me frikën ka pasqyruar se si pasojë e aksidentit të shkaktuar, ka përjetuar frike primare me kohëzgjatje prej 1 deri ne 2 sekonda.

Frike sekondare e intensitetit të lartë është periudha pas aksidentit e deri tek lirimi nga trajtimi ne Spitalin e Përgjithshëm ne Mitrovicë e cila është percjellur me frike, ankth, te gjeneralizuar, mendime skeptike, habi, mendime negative për pasojat qe mund ti këtë pasur nga trauma e përjetuar.

Te gjitha këto sjellin ne konstatim se e njëjta ka përjetuar frike sekondare prej intensitet te larte prej 3 orësh.

Frike sekondare te intensitetet te mesëm është periudha pas daljes nga qendra emergjente, vazhdimi i trajtimit nga shtëpia, dhe konsultat e mara nga mjeket për tejkalimin e gjendjes në të cilën njëjta ndodhet gjatë kësaj periudhe janë shfaqur simptomat si pagjumësia, frika, mendimet skeptike, kokëdhimbje dhe e gjithë kjo me kohëzgjatje prej 21 ditësh.

Frike sekondare e intensitetit te ulet është procesi ne vazhdimësi me simptomatologji te larte cekur por me intensitet me te ulet ku ne këtë faze prezimtonon rikujtimet e ngjarjes traumatike, anashkalim i bisedave për traumën e përjetuar, pagjumësia, kokëdhimbje, dhe ankthi i gjenariluzar.

Te gjitha këto kane vazhduar edhe për një periudhë kohore prej 14 ditësh.

Gjykata të dy ekspertizave mjekësore atë të ortopedisë dhe psikiatrisë, i ka pranuar në tërësi si të besueshme, meqë të njëjtat ishin profesionale dhe të argumentuara, po ashtu të punuara sipas vëllimit të përcaktuar, duke ofruar të dhëna lidhur me vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore.

Në emër të kompensimit të demit material të shkaktuar në veturën e paditësit Fadil Bajraktari, e markës VW 255 targa 02-733-AC, në aksidentin e komunikacionit te dt. 29.12.2016, gjykata i ka caktuar shpërblimin paditësit Fadil Bajraktari, bazuar në ekspertizën e makinerisë e dt. 15.02.2024, si dhe asaj të komunikacionit e dt.26.01.2024

Eksperti i makinerisë V. B në bazë të analizimit të dëmtimeve në automjet ka konstatuar se dëmi në automjetin VW 255 është në pjesën anësore të majtë, të anës së pasme, vlera mesatare e automjetit VW 255 në kohen e aksidentit ka qenë 2.598€, riparimi i automjetit në aspektin ekonomik është rentabil, vlera e demit në automjet është 503€.

Eksperti i makinerisë S.B në ekspertizën e dt.26.12.2016, ka konstatuar ngasësi i automjeti A nuk e ka përshtatur shpejtësinë sipas kushteve dhe rrethanave ne komunikacion ( reshje bore dhe rruga me ngrica) si dhe fushëpamjes, dukshmëria ka qene e dobët (errësire), ngasësi është dashur

ta përshtat shpejtësinë përveç tjerash edhe me rrezen e dritave te përparme qe mjetin ta ndale brenda tufës se dritave te shkurta (40-80m) ose dritave te gjata, pra ngasësi A e ka neglizhuar rrezikun dhe e ka shfrytëzuar rrugën drejte duke zhvilluar shpejtësi te rrezikshme, kështu duke shkaktuar aksidentin e komunikacionit, por edhe nga moskujdesi ne ngasje duke humbur kontrollin dhe manovruar me timon (majtas-djathtas). Ngasësi i automjeti B e ka parkuar automjetin ne shiritin e djathte te rrugës ne dukshmërinë e zvogëluar, ky i njëjti nuk i ka marre masat e sigurisë për ndalje ne rruge, ngasësi i cili për shkak te defektit ne mjet ose për ndonjë shkak te arsyeshëm ka qene i detyre ta ndale mjetin ne rruge është i detyruar qe ti marr te gjitha masat qe mjeti i ndalur ne rruge mos te pengon ose rrezikon komunikacionin dhe menjëherë te largohet, ngasësi B është dashur qe mjetin te shënojë me ane te vendosjes se trekëndëshit te sigurisë, ne distance prej 10 m pas mjetit. Me veprimet e tij ka kontribuar ne aksident. Andaj duke u bazuar ne te larte cekurat konstatohet se automjeti VW Golf është shkaktar primar i aksidentit, ndërsa automjeti VW 255, i ka dhënë kontribut sekondar aksidentit.

Nga provat e administruara, me theks të veçantë ekspertiza e komunikacionit te nxjerr ne procedurë civile, dhe pasi qe në mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese kontributi ne shkaktimin e aksidentit, gjykata gjeti se në këtë rast të siguruar, përgjegjësinë për aksidentin dhe për dëmin e mbanë i siguruari tek e paditura e parë 80% dhe nga e paditura e dytë 20% nga baza e auto përgjegjesisë. Gjykata vendosi të mbajë të paditurën e parë KS SIGURIA përgjegjëse për kompensimin e dëmit të shkaktuar në 80% të përgjegjesisë, gjykata ka aprovuar padinë në shume prej 402.40 €.

Në këtë drejtim, me rastin e caktimit të lartësisë së dëmit për bazat e gjykuara gjykata pati parasysh edhe faktin e përgjegjesisë së ndarë të palëve ndërgjyqëse dhe kontributin e tyre në dëmin e shkaktuar, pasi që gjykata vlerësoi në këtë mënyrë duke u bazuar në ekspertizën e komunikacionit, të cilës gjykata ia fali besimin, e sipas të cilës ndonëse paditësi Fadil Bajraktari kishte dhënë kontribut sekondar ne shkaktimin e aksidentit, me veprimin e tij ka ndikuar në rritjen e vëllimit të dëmit.

Sa i përket përgjegjesisë së ndarë në rritjen e vëllimit të dëmit, gjykata ka aplikuar dispozitën e nenit 176 par. 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) 04/L-077, sipas të cilit I dëmtuari i cili ka kontribuar që dëmi të krijohet ose të jetë më i madh se sa përndryshe do të ishte, ka të drejtë vetëm në shpërblimin përpjesëtimisht të pakësuar, e ne lidhje me nenin 189 të LMD-së sipas të cilit Dispozitat për përgjegjësinë e ndarë dhe për zvogëlimin e shpërblimit që vlejné për dëmin material përshtatshëmish zbatohen edhe për dëmin jomaterial.

Gjykata vë në dukje se tek rastet e përgjegjesisë së ndarë, shkaktuesi i dëmit – e paditura duhet të ofrojë prova lidhur me kontributin e paditësit, kurse në anën tjetër, palës paditëse i takon barra e provës për të përcaktuar kontributin e të paditurës. Ashtu siç edhe u vlerësua me provat e administruara në këtë procedurë gjyqësore, provat dërguan që gjykata të arrijë deri tek një gjendje faktike e vërtetuar veprimet e paditësve në dëmin e krijuar. Së këndejmi, gjykata bëri balancimin e shumave të kompensimit në përpjesëtim me përgjegjësinë e palëve.

Për lartësinë e kërkesë padisë dhe për kategoritë e caktuara për aspektin e dëmit jo material dhe material gjykata vendosi duke u mbështetur në dispozitat e Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) 04/L-077, i cili ligj rregullon çështjen e kompensimit të dëmit (material dhe jo material).

Neni 137 i LMD-së thotë: Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material).

Kurse me dispozitën e nenit 183 par. 1 e LMD-së përcaktohet se “Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëndetit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material”, e ne lidhje me nenin 323 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, me këtë rast gjykata pati parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës, dhe qëllimin të cilit i shërben kompensimi i gjykuar, gjithmonë duke pasur parasysh, që kompensimi të jetë satisfaksionin, për të dëmtuarën, duke ndikuar kështu në zbutjen e pasojave negative që janë paraqitur si pasojë e dëmit në cenimin e vlerave personale të paditësve.

Gjykata, pasi konstatoi rrethanat e rastit duke pasur parasysh lartësinë e kompensimit për këtë kategori të dëmit jo material, e mori parasysh natyrën e lëndimeve trupore të cilat i kishte pësuar paditësja F.K, në aksidentin e ndodhur, mënyrën e manifestimit, intensitetit dhe kohëzgjatjen e frikës së përjetuar, por edhe praktikën e gjertanishme gjyqësore, duke u siguruar që kompensimi në shumën e gjykuar për këtë lloji dëmi të jetë satisfaksion për paditësit, duke shmangur tjera materiale (lukrative) që mund të bien ndesh me qëllimin e kompensimit në raste të tilla, praktikën e mirë gjyqësore, andaj vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit në pjesën e aprovuar, si dhe duke iu referuar paragrafit 2 të nenit 183 të LMD-së përcaktohet se “Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jo material, si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, e gjithashtu edhe për faktin se me të, të mos u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”.

Pra, nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore rezulton se kompensimi duhet të jetë adekuat me kohëzgjatjen e dhimbjeve të përjetuara, ashtu që kompensimi të përfaqësojë një lehtësim në përbalimin e tejkalimit të pasojave të dëmit që në këtë rast paditëses, i kanë pësuar në aksidentin e komunikacionit.

Në emër të ushqimit të përforcuar gjykata ka caktuar kompensimin bazuar në ditët që ishte vlerësuar si e domosdoshme sipas ekspertizës së ortopedisë, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse paditësit sipas mendimit të ekspertit të mjekësisë si pasojë e aksidentit ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar i pasur me vitamina, proteina dhe minerale 10 ditë.



Në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj dhe rehabilitimit fizioterapeutik gjykata ka caktuar kompensimin në harmoni ditët që paditësja F.K kishte nevojë për këtë lloj ndihme dhe këtë lloj rehabilitimi, ngase sipas mendimit të ekspertit të mjekësisë si pasojë e aksidentit ka pasur nevojë për ndihmën dhe kujdesin e huaj 5 për t'i kryer shumicën e aktiviteteve të përditshme jetësore siç janë ushqimi, veshmbathja, higjiena dhe ndihma gjate trajtimit mjekësor, si dhe rehalibimitm fizioterapeutik 18 ditë ne vitin e parë pas aksidentit.

Gjykata për kategoritë dëmit ushqim i përforcuar, ndihmë dhe kujdes i huaj, dhe rehabilitim fizioterapeutik vlerëson se mund të caktohet edhe në mungesë të provave materiale, ngase është standard i ndërtuar tashmë nga praktika gjyqësore.

Andaj pas analizimit të të gjitha provave ka ardhur në përfundim se shumata e gjykuara të shpërblimit të dëmit për këto kërkesa janë në përputhje me dëmin e pësuar sipas këtyre bazave. Gjithashtu, gjykata vë në dukje se për këto tri kategori të dëmit për paditësin, është vendosur brena kufijve të kërkesëpadisë, duke aplikuar nenin 2 par 1 të LPK-së, sipas të cilit “Në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse”.

Gjykata vlerëson se shpërblimi i dëmit jo material, nuk është shpërblim i plotë, por është satisfaksion, për të dëmtuarit, çka në rastin konkret shumata e gjykuara janë të drejta për të.

Gjykata sa i përket aprovimit si ne piken I te këtij dispozitivit sa i përket demit material për paditësin F. B u bazua në ekspertizën e makinerisë.

Gjykata duke u bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike si më lartë, vlerësoi se e paditura e parë pjesërisht mban përgjegjësi për dëmin që është shkaktuar, palëve paditëse, me rastin e lëndimit, dhe dëmit të pësuar në automjet, në aksidentin e trafikut, për çka e paditura e parë është e obliguar që ta kompensoi mbi bazën e sigurimit të auto përgjegjësisë, konkretisht sipas nenit 10 te Ligjit te Detyrueshëm nga auto përgjegjësia e në lidhje me nenin 136, 140, 169, 179, 183 par.1 dhe 2 dhe 245 par.1 dhe 2 të LMD-së.

Kurse barra e të provuarit bie mbi atë qoftë kur e ngrit një pretendim apo parqet një kërkesë po ashtu edhe për atë që paraqet kundërshtim për të rrezuar pretendimin e palës kundërshtare, pra nuk mjafton vetëm kundërshtimi deklarativ, po ai kundërshtim duhet të materializohet me propozimin e provave me të cilat argumentohet, sepse në të kundërtën gjykata nxjerr vendim mbi bazën e provave të administruara dhe është arbitër i pavarur dhe i paanshëm sepse në të kundërtën del jashtë rolit të caktuar me ligj, pra pala e paditura e parë kundërshtimet e veta është dashur ti provoj sipas detyrimit ligjorë te paraparë me Ligjin e Procedurës Kontestimore ku thuhet, citoj 322.1 “Në qofte se gjykata në baze te provave të marra ( neni 8 i këtij ligji) nuk mund te konstatoj me siguri ndonjë fakt , për ekzistimin e faktit do te përfundojë duke i aplikuar rregullat mbi barrën e provës”. 322.2, “Pala që prendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po qe se ligji nuk parasheh diçka tjetër”. 322.3 “Pala e cila e konteston ekzistimin e ndonjë te drejtë e bartë barrën e të provuarit të faktit që e ka penguar krijimin apo realizimin e saj, ose në baze të të cilit ka pushuar se ekzistuari , po qe se ligji nuk parasheh diçka tjetër “ ndërsa neni 319.1 “Secila nga palët

ndërgjyqëse ka për detyrë të provoje faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”, 319.2 “Të provuarit përfshihen ne te gjitha faktet qe janë te rëndësishme për dhënien e vendimit” , atëherë ndërlidhur me nenin 136 të LMD-se qarte del detyrimi i të paditurës , qe se pari të argumentoi se demi ka lind pa fajin e saj dhe në mes të demit dhe pasojës nuk ekziston lidhja kauzale shkak pasojë.

Gjykata refuzoj shumat për dëmin material dhe jo material si në pikën III të dispozitivit përtej shumës së gjykuar pasi që nuk janë në harmoni me dëmin e pësuar dhe nuk përkojnë me praktikën gjyqësore dhe me Udhëzues të Gjykatës Supreme me nr. GJ.A-Su.A 41/2023 dt.27.02.2023 dhe atë për paditësen F.K, për dhimbje fizike, shumën prej 3,300.00€, për friken e pësuar, shumën prej 3,300.00€, për ndihmë personit te huaj shumen prej 100 euro, ne emër të ushqimit te përforcuar shumen prej 60 euro, për rehabilitim fizik 150 euro, apo shumën e përgjithshme për të gjitha kategoritë e demit prej 6,910.00€, pasi që shumat e kërkuara nuk janë ne harmoni me dëmin, përgjegjësin e pjesëmarrësve në komunikacion dhe praktikën gjyqësore.

Prandaj, shumat e gjithmbarshme të kompensimit janë refleksion i zbritjes së tyre në kuptim të asaj përqindje.

Gjykata vlerëson të theksojë se me rastin e caktimit të lartësisë së kompensimi për secilën kategori të demit material dhe jo material, është konsideruar se i siguruarit tek e paditura e dytë kishte pasur pjesëmarrje në kuptim të përgjegjësisë për rritjen e vëllimit të demit në lartësi 20%, mirëpo gjykata e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësve në raport me te paditurën KS SIGAL duke u bazuar në dispozitën e LMD në nenin: 357, par.1, ka përcaktuar “Kërkesa për shpërblimin e demit të shkaktuar parashkruhen për tri (3) vjet nga data kur i dëmtuari ka marrë dajeni për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin”. Andaj në kuptim të kësaj dispozitë ligjore gjykata ka ardhur në përfundim së kërkesëpadia e paditëse është e pabazuar ne raport m te paditurën e dytë për shkak së është e parashkruar, pasi që njëjta është paraqitur pas afatit ligjor, pasi që nga raporti policor i aksidentit i dt. 29.12.2016 është konstatuar fakti se deri të aksidenti kishte ardhur kur automjeti (A) ishte duke lëvizur në rrugën e quajtur rr: “Fadil Deliqi” nga qendra e qytetit në drejtim të lagjes Bair dhe me të arritur me saktë në afërsi tek DPT “ E” nga pakujdesia duke mos përshtatur shpejtësinë e lëvizjes dhe kushteve të rrugës pasi që rruga ishte e rrëshqitshme, drejtuesi humb kontrollin ndaj automjetit dhe del në shiritin e kundërt të lëvizjes dhe ku me pjesën përparme anësore të anës se djathtë e godet automjetin B, në pjesën e prapme anësore të anës së majte, i cili në atë moment ishte i ndalur para tij në drejtim të lëvizjes dhe nuk e kishte vendosur trekëndëshin e sigurisë në rruge si pasoj e goditjes automjeti B me pjesën e përparme të anës së djathtë e godet automjetin C, në pjesën e prapme të anës së majte, i cili në atë moment ishte i parkuar përpara hyrjes se shtëpisë se B.B dhe si pasoj e kësaj përveç dëmeve materiale ne automjet, lëndime marrin drejtuesi i automjetit A dhe bashkudhëtarja ne automjetin, nga ky raport policor paditësit janë vënë ne dajeni se ne rastin konkret përpos drejtuesit të automjetit A si shkaktues i aksidentit, shkaktimit te aksidentit i ka kontribuar edhe i siguruarit te e paditura e dytë, andaj për vlerësimin e gjykatës të dëmtuarit-paditësja janë vënë në dajeni për dëmin dhe dëmtuesin (të paditurinë dytë), nga data 29.12.2016, ndërsa padinë e kanë zgjeruar në raport me të paditurën me dt. 01.02.2024, përkatësisht pas 7 viteve, duke llogaritur nga dita

e shkaktimit të aksidentit, ndërsa padia është dashur të ushtrohet brenda 3 vjetëve, andaj gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi konform nenit 357 par. 1 të LMD-së.

Përtej shumave të aprovuara si në pikën I të dispozitivit, gjykata vlerësoi se kompensimi, nuk do të ishin në harmoni me të mirën e shkelur dhe me qëllimin që kompensimi të ishte i drejtë. Gjykata vlerëson të theksojë se me rastin e caktimit të lartësisë së kompensimi për secilën kategori të dëmit material dhe jo material.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi lidhur me kamatën, pasi që paditësve ju takon kamatëvonesa, kurse lidhur me lartësinë e kamatës së llogaritur prej 8 %, vendosi në kuptim të nenit 382 të LMD-së, sipas të cilit debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhi të kryesor, edhe kamatën, sa i përket dëmit material dhe jo material në total të shumës prej 2,127.60€ €, ti paguaj me kamatë ligjore prej 8%, dhe atë për dëmin material në shumë të përgjithshme prej 777.60€, kamata do të rrjedhë nga data 31.03.2017 si datë e ushtrimit të padisë, kurse për dëmin jo material në shumë të përgjithshme prej 1,400.00€, kamata do të rrjedhë nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit datë 27.03.2024, e deri në pagesën definitive të detyrimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

Gjykata me rastin e vendosjes pati parasysh edhe mendimin juridik të Gjykatës Supreme lidhur me kamatën në situatën konkrete dhe në harmoni me të njëjtin vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Vendimin që e paditura e parë pjesërisht të bart shpenzimet e procedurës si në pikën IV, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452, e lidhur me nenin 463 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditësve në këtë procedurë.

Lartësia e shpenzimeve të procedurës të aprovuara i referohen shpenzimeve të përfaqësimit të autorizuarit të palës paditëse dhe atë: për përpilim e padisë shumë prej 208.00 euro, për 5 seanca të përfaqësuar nga avokati nga 202.80€ ( 5x 202.80=1,014.00€ pasi që janë 2 paditës) sipas Tarifës së Odes së Avokateve të Kosovës, për ekspertizë mjekësore të Ortopedisë dhe Psikiatrisë si dhe për ekspertizë të makinerisë dhe Komunikacionit shumë prej 600.00 €, (150 x 4 = 600€) si dhe 25 € në emër të taksës për padi, apo në total shumë e përgjithshme prej 1,847.00 €, mirëpo meqenëse kemi përgjegjësi 80 me 20, atëherë gjykata në bazë të suksesit në procedurë paditësve ua njohu 80% të shpenzimeve, andaj nga shuma e përgjithshme që do të ju takonte paditësve prej 1,847.00, të cilën shuma gjykata e ka pjesëtuar me 80, dhe shuma që obligohet e paditura e parë KS SIGURIA të ua paguaj paditësve arrin në lartësinë prej 1,477.60 €, të cilën shumë e paditura e parë obligohet ta paguaj brenda afatit 15 ditor nga pranimi i aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

Ndërsa pjesën tjetër të refuzuar pjesërisht si në pikën V të dispozitivit lidhur me shpenzimet sa i përket precizimit të kërkesëpadisë prej 208.00€, si dhe për parashtrësën e zgjerimit të padisë shumen prej 208.00€, gjykata e refuzoj me arsyetimin se precizimi i padisë, është petitumi i padisë dhe paditësve ju ka njohur 208.00 € në emër të përpilimit të padisë, sa i përket zgjerimit të padisë e paditura e parë nuk mund të ngarkohet me shpenzime që janë shkaktuar pa fajin e

sajë pasi që nga raporti policor është konstatuar se edhe pala B ka pasur lëshime ne shkaktimin e aksidentit, ashtu që paditësit e kanë ditur për shkaktaret e aksidentit nga data 29.12.2016, si dhe për pesë seanca te mbajtura shumën nga 67.60€ për çdo seancë, pasi që sipas tarifës se avokatëve nr. tarifor 7 tek kontestet mbi vlerën e vogël konstatohet se për paditësin e dytë/të paditurin e dytë shumën 202.80 €, kurse paditësit kanë kërkuar shumën prej 270.40 €, andaj përtej shumes prej 202.80 € gjykata i refuzoj si te pabazuara, po ashtu gjykata refuzoj edhe 20% të shpenzimeve a po 369.40 €, që do të ju takonin paditësve nëse do ishte përgjegjësia e të paditurës së parë 100%, apo nëse do të aprovohej padia ne raport me të paditurën e dytë, apo ne total shuma e shpenzimeve të refuzuara në lartësi prej 1,123.40€.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata aktgjykimin e bazoj në nenin 143 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**  
**C.nr.169/2017,dt.28.03.2024**

**G j y q t a r i**  
Blerim Istrefi

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga pranimi i të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.